



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 395, datë 21.09.2022**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË**

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çështjen administrative me Paditës: {...}, {...}, {...}; E paditur: {...}; Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë, të realizojë veprimin administrativ që të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë {...}shpk, Nr. Prot. {...}datë 6.12.2021 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

2. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Etleva Gjamo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çështjen administrative me Paditës: Shoqëria {...}’ shpk, {...}, {...}; E paditur: {...}; Objekti: Detyrimin e palës së paditur {...} të realizojë veprimin administrativ që të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë {...}shpk, Nr. {...} datë 6.12.2021 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

## **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Alma Ahmeti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura, e mbetur në tentativë; Viktima e veprës penale: {...}.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**